

Për:	Operatori Ekonomik: "AL - GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.04.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës: 01.04.2020, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "AL – GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: 623-20-775-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, nxjerr:

VENDIM

REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "AL – GROUP" Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **HARTIMI I PROJEKTEVE TË NDRYSHME**, me Numër të prokurimit: 623-20-775-2-1-1, Nr. i brendshëm: 623-20-001-2-1-1, pasi që tek formulari: B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, tek Neni IV.2.3) Teksti i cili duhet të përmirësohet/shtohet në njoftimin original thotë: Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për sqarimin e dosjes së tenderit është: 30.03.2020.

Andaj sipas Ligjit të Prokurimin Publik, Kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet pasi që nuk është dorëzuar brenda afateve kohore të përcaktuara në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Vërejtje: Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.